

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“JomaFarm” shpk**

Ne Tirane, sot me date 14 Mars 2024, ne cilesine e “ortakeve themelues”:

**Znj. Jonila Shytaj**, e ditelindjes 11/10/1981, lindur ne Tirane, dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pashaportes me nr. I16011099E

**Znj. Madalena Hoxha**, e ditelindjes 07/02/1976, lindur ne Orikum, dhe banuese ne Orikum, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr personal H65207037D,

ne cilesite e “ortakeve themelues”, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartuan kete akt themelimi per krijimin e shoqerise pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**JomaFarm**” shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare“ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskale Tatimor.

**KREU I**  
Neni 1  
Krijimi

Shoqeria “**JomaFarm**” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “JomaFarm”**.

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.  
Shoqëria “**JonaFarm**” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i shoqerise”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.  
Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Kavaje, ne adresen : nr. Pasurie 330/2, Vile Ballaj. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4  
Objekti i veprimtarise

*Jonila Shytaj*  
*JH*

*Madalena Hoxha*  
*MH*

Qëllimi i kompanisë është:

- Tregtim, marketing, branding, publikimin, reklamimin dhe realizimin e import - eksporte të imputeve bujqësore; si dhe çdo lloj veprimtarie të lidhur me kulturat bujqësore që do t'i shërbeje aktivitetit të shoqërisë.
- merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, përpunon, tregton, blen, shet ose merret me çdo mënyrë a mjet tjetër me produkte bujqësore.
- Shërbime bujqësore, prodhimin, përpunimin dhe tregtimin në fushën e produkteve bujqësore në tërësi si plugime, sperkatje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi etj, si dhe eksport import sipas nevojave.
- Në përputhje me legjislacionin shqiptar, ka të drejtë: të mundësoj trajnime profesionale për anëtarët e saj apo palët e treta, të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie - marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë.
- Rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të fermerve në treg; Promovimin e eksporteve; Konsolidimi i kanaleve të marketingut bujqësor; Institucionalizmi i bashkëpunimit në bujqësi; Përfitim të granteve qeveritare dhe internacionale dhe atyre në bashkëpunim nga një numër sa më i madh fermerësh; Ndermjetesimi midis prodhuesve dhe transformtoresh në sektorin agro-zooteknik të rajonit. Kryerja e studimeve dhe kerkimeve në fushën agro-zooteknike. Kerkimi i donatoreve dhe burimeve të financimit. Shkrimi dhe prezantimi i projekteve.
- Të zotrojnë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavaresisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri, të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të antarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### Neni 5 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

### **KREU II KAPITALI**

#### Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 lekë.

Kapitali i mesiperm është nënshkruar dhe do të shlyhet sapo të hapen llogaritë bankare të shoqërisë tërësisht në të holla nga "ortaket e shoqërisë":

**Znj. Jonila Shytaj** është zotuese e 1 kuote me vlerë 1.000.000 leke, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Znj. Madalena Hoxha** është zotuese e 1 kuote me vlerë 1.000.000 leke, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

*Jonila Shytaj*  
SH

*Madalena Hoxha* 2  


Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit të nje eksperti të autorizuar per keto kontribute ne natyre. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asambleja e Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotaveka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU II**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9  
Organi Vendimmarres

Asambleja e përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet

- Sipas ketij akti të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.
- Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
  - përcaktimin e politikave tregtare;
  - ndryshime të statutit;
  - emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe(në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
  - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" tëkësaj pike;
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

*Spule Shyky*  
*Shy*

*Madalena Hoxha* 3  
*[Signature]*

- h. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- i. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- m. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Z.Saimon Gaba** mbajtes i ID me nr. K40515036M. Administratoret e shoqërisë do të ushtrojnë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërteritje.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i trete jashtë ortakerisë.

#### Neni 11 Kompetencat

Administratoret ka të drejtë e detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtezakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakeve;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakeve për miratim;
- e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asambleja e Ortakeve edhe në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat

*Saimon Gaba*  
SG

*Modaleus Hoxha* 4

e fundit financiare të certifikuara,  
Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 12 Përgjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

Madalena Hoxha  




- c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Asambleja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15  
Baza Ligjore


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Nëse nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16  
Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqërisë "JomaFarm" shpk, u redaktua me vullnetin të lirë e të plotë "ortakëve themelues", në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane.

**ORTAKET E SHOQËRISË**

Z. Jonila Shytaj



Z. Madalena Hoxha

